

Më të rejat nga Ekonomia Qarkore

Kosovë · Rajon · Evropë
Tetor 2025 – Shkurt 2026

Ekonomia qarkore po kalon nga ide dhe projekte pilote në praktika konkrete, produkte reale dhe politika detyruese. Ky buletin sjell një përmbledhje kronologjike të zhvillimeve kryesore në Kosovë, rajon dhe Bashkimin Evropian.

Çka po ndodh në Kosovë?

Podcast realizuar nga Rilindja Gjellbër | Industria e ushqimit dhe ekonomia qarkore



Sillu' Pshtillu', Episodi 2 – Qëndrueshmëria në industrinë ushqimore
Në episodin e dytë të podcastit 'Sillu' Pshtillu', u prezantua një bisedë thelbësore dhe frytëzuese mbi rolin e industrisë ushqimore në ekonominë qarkore dhe shëndetin publik.

Të ftuara:

- **Emine Daci Zejnullahi** – Drejtoreshë & Themeluese, Quality Life Centre – Bio 365 Kosovo
- **Edona Demaj** – Drejtoreshë Menaxhuese, Eco Kos

Sipërmarrëset ndanë përvojat konkrete, sfidat strukturore dhe mundësitë reale për ndërtimin e modeleve ushqimore më të qëndrueshme në Kosovë, një sektor kyç për mirëqenien e komunitetit dhe ekonominë qarkore të vendit.

Trajnim për industrinë e tekstilit në ekonomi qarkore

Gjatë kësaj periudhe është realizuar një trajnim i dedikuar për industrinë e tekstilit, me fokus në:

- Praktikant e ekonomisë qarkore;
- Riciklimin dhe mbiciklimin;
- Modelet e qëndrueshme të prodhimit.

Qëllimi i trajnimit ishte të mbështesë bizneset lokale në tranzicionin drejt proceseve më të gjelbra dhe më konkurruese.

Më shumë:

<https://re-ko.org/trajnim-dhe-punetori-mbi-ekonomine-qarkore-ne-industrine-e-tekstilit-11-13-dhjetor/>

Moda qarkore | Tekstili i ripërdorur shndërrohet në koleksione kreative

Në kuadër të projektit "Rikthimi i vlerave në ekonominë qarkore" të ekzekutuar nga Rilindja Gjellbër, ka nisur krijimi i dy koleksioneve të modës nga tekstili i ripërdorur, duke dëshmuar potencialin e industrisë kreative në tranzicionin qarkor.

- **Pejë** – Koleksioni po zhvillohet në bashkëpunim me dizajnerin Etnik Shala dhe nxënësit e Shkollës së Mesme të Artit "Odhise Paskali";
- **Prishtinë** – Koleksioni po krijohet nga dizajnerja Vesa Rukiqi, në bashkëpunim me Akademinë Evolucion.

Këto iniciativa tregojnë se mbetjet tekstile mund të shndërrohen në produkte me vlerë të lartë estetike dhe ekonomike, duke fuqizuar të rinjtë dhe dizajnerët lokalë.

Shihni më shumë:

<https://www.instagram.com/p/DT-w4DyjAcz/>
<https://www.instagram.com/p/DSAb10HinLN/>

Inovacion në riciklim | Produkte të reja nga mbetjet

Kompanitë kosovare të riciklimit po e shndërrojnë ekonominë qarkore në **produkte konkrete dhe të tregtueshme**.

Kosovo Glass Recycling (KGR) vazhdon të zgjerojë gamën e produkteve të saj duke transformuar mbeturinat e qelqit në materiale me vlerë të lartë.

Produktet ekzistuese përfshijnë:

- Tavolina, bare dhe banakë (countertops);
- Qelq të grimcuar për filtrim pishinash;
- Qelq të grimcuar si lëndë e parë për industri të tjera;

Risi e fundit:

- **Rubinet terrazzo**, të përshtatshëm për shtëpi, lokale dhe hotele – një shembull i dizajnit funksional nga riciklimi.

Më shumë:

<https://www.facebook.com/KosovoGlassRecycling>

DYVÓLAB | Punëtoritë e mbiciklimit

DYVÓLAB vazhdon të promovojë kreativitetin dhe inovacionin përmes punëtorive të mbiciklimit. Gjatë dhjetorit, u realizua punëtorja e stolive, ku pjesëmarrësit shndërruan mbeturinat plastike në ornamente unike dhe kreative.

Programi "Ditët e Hapura të Laboratorit" hap thirrje çdo tre muaj për ide që adresojnë menaxhimin e mbetjeve në mënyrë kreative dhe me ndikim komunitar. Projektet e përzgjedhura kalojnë një proces inkubimi tre-mujor – nga ideja te prototipi.

Më shumë:

<https://dyvolab.com>

Zhvillimet në rajon

Çmimet për Ekonominë Qarkore në Ballkanin Perëndimor

Iniciativat më të suksesshme në rajon janë vlerësuar për kontributin e tyre në zhvillimin e ekonomisë qarkore:

- Civil Society Circular Economy Award Rilindja Gjellbër (Kosovë);
- Circular Start-up – Recycling Albania (Shqipëri);
- Circular Economy Education & Research Award Brunilda Kosta (Shqipëri);
- Circular Corporate Leadership – Hemosan (Mal i Zi);
- Innovative Circular Design – 3D Soba (Mal i Zi);
- Municipal Circular Leadership – Qyteti i Smederevës (Serbi);
- Circular Economy Pioneer – Radovan Nikčević (Mal i Zi).

Më shumë:

<https://wbcirculareconomy.com/circular-economy-awards-2025-the-western-balkans-first-regional-winners-announced/>

Çka po ndodh në Bashkimin Evropian?

Si filloi viti 2026?

Në vitin 2026, Bashkimi Evropian po avancohet seriozisht tranzicionin drejt një ekonomie më qarkore përmes legjislacionit të ri dhe politikave gjithëpërfshirëse.

Circular Economy Actv

Një nga nismat kyçe që pritet të miratohet gjatë vitit 2026, me qëllime të qarta:

- Krijimin e një Tregu të Vetëm për lëndët e para dytësore;
- Krijimin e furnizimit me materiale të ricikluara me cilësi të lartë;
- Stimulimin e kërkesës për këto materiale brenda BE-së.

Tendencat kryesore për 2026:

Legjislacioni po kalon nga parimet e përgjithshme në efekte të matshme për bizneset dhe zinxhirët e furnizimit. Rregullore si:

- PPWR (ambalazhet);
- CSRD (raportimi i qëndrueshmërisë);
- CSDDD;
- ESPR (ecodizajni);
- CBAM (taksa e karbonit për importet);

po vendosin standarde të reja që kërkojnë integrimin sistematik të ekonomisë qarkore në biznes.

Kjo do të thotë:

- Fokus në cilësinë e materialeve të ricikluara;
- Dizajnim produktesh që zgjasin, riparohen dhe riciklohen;
- Përdorim të të dhënave dhe gjurmueshmërisë;
- Modele të integruara biznesi nga burimi te ripërdorimi.

Burime:

https://environment.ec.europa.eu/strategy/circular-economy_en
<https://www.reconomy.com/2026/01/29/circular-economy-trends-2026/>